

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me zyrtaren ligjore Florentina Ademi, në lëndën penale ndaj të pandehurit **V. A nga Gj**, të cilin me autorizim e mbronpër shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2577/2013 e datës 23.12.2013, të cilën e përfaqësonte prokurori i shtetit Shefik Memeti, pas mbajtjes së seancës fillestare dhe publike, më datën 06.09.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **V. A**, nga babai **Idhe nëna S**, e lindur **K .i lindur më ..në Gj**, ku edhe tani jeton, , i martuar, babë i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Më parë i pa gjykuar, dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

Është fajtor

Sepse më datën 19.12.2013, rreth orës 01:00, në , saktësisht përballë kafiterisë "", i pandehuri, pas një mosmarrëveshje që kishin pasur me tani të dëmtuarin **Osman Morina**, rreth asaj se i pandehuri kishte kërkuar nga i dëmtuari i cili njëkohësishtë është taksist, që ta dërgojë në Viti pa të holla, por me që i dëmtuari nuk kishte pranuar me një gjë të tillë, atëherë i pandehuri fillimisht e fyer me fjalë të ndryshme të dëmtuarin, e më pas e godet me grushta në fytyrë, me ç'rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, sipas raportit mjekësor me numër të protokollit .. të datës...., të lëshuar nga Spitali Regjional i Gj-Emergjencia.

- me çka ka kryer vepër penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17, 49, 50, 51, 52, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 365 dhe 451 të KPP, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit V.A.i caktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë, nëse në afat prej 1 **(një) viti** nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari O. M nga , për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë perfundimtare të kësaj gjykate, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit V. A për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2577/2013, e datës 23.12.2013.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik të mbajtur me datë 06.09.2017, prokurori i shtetit Shefik Memeti, gjatë fjalës përfundimtare deklaroi: se mbetet në tërësi pranë aktakuzës lëndore, meqë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në këtë seancë fillestare, atëherë nuk është i nevojshëm administrimi i provave. I propozoj gjykatës që të njëjtit t'ia shqiptoj një sanksion penal duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të të pandehurit.

Mbrojtësi i të akuzuarit V. A. gjatë fjalës përfundimtare deklaroi: pasiqë i mbrojturi im në këtë fazë të procedurës e ka pranuar fajësinë, mua nuk më mbetet asgjë tjetër veq se të kërkoj që gjykata të njëjtit t'ia shqiptoj një dënim sa më të but, pasiqë është në gjendje të rëndë ekonomike, mbajtës i familjes 7 anëtarëshe, i pa punë, dhe se i premtun gjykatës se një gjë të tillë më nuk do ta përsërisë, pasi që

edhe kjo është vepra parë e tij penale, andaj, një dënim i kushtëzuar do të ishte adekuat me veprën e cila i vihet në barrë.

I akuzuari, gjatë fjalës përfundimtare deklaroi: i bashkangjitem fjalës përfundimtare të avokatit tim dhe se është hera e parë që e kam kryer veprën, dhe i premtoj gjykatës se një gjë të tillë më nuk do ta përsërisë, andaj, i kërkoj gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana dhe të më shqiptoj një dënim më të butë, mundësisht me kusht.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, me datë 06.09.2017, pas leximit të aktakuzës, i pandehuri, ka deklaruar se e kam kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohem, duke theksuar se e pranoj fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjykata, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

- se është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar si në hyrje të këtij aktgjykimi – sepse më datën 19.12.2013, rreth orës 01:00, në , saktësisht përballë, i pandehuri, pas një mosmarrëveshje që kishin pasur me tani të dëmtuarin, rreth asaj se i pandehuri kishte kërkuar nga i dëmtuari i cili njëkohësisht është taksist, që ta dërgojë në Viti pa të holla, por me që i dëmtuari nuk kishte pranuar me një gjë të tillë, atëherë i pandehuri fillimisht e fyer me fjalë të ndryshme të dëmtuarin, e më pas e godet me grushta në fytyrë, me ç'rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, sipas raportit mjekësor me numër të protokollit 22408 të datës 19.12.2013, të lëshuar nga Spitali Regjional i Gjilanit-Emergjencia.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit V. A gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjelljen shumë të mirë të tij gjatë shqyrtimit fillestar, ka

shprehur keqardhje për rastin e ndodhur si dhe i ka premtuar gjykatës se më nuk do të kryejë vepër tjetër penale.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 , ndërsa vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike në nenin 463 të KPP-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 06.09 2017

**Zyrtarja ligjore
Florentina Ademi,**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*